

**STATUTI**  
**I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“X-Identity”**

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri, dhe Themeluesit**

1.1 Sot, më **06 /01/ 2022**, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **“X-Identity” SH.P.K.**

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:

- a) **Z. Gjergji Prendi**, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 02 Nëntor 1990, mbajtës i ID nr. 035390066, banues në: Rr: “Adem Jashari”, Pall. 1, shk.1, ap.7, Tiranë dhe me adresë e-mail përfekt njoftimi sipas këtij dokumneti: [g@x-identity.com](mailto:g@x-identity.com), me zotësi të plotë përf të vepruar.
- b) **Z. Zachary Michael Lennon**, lindur në Michigan, SH.B.A, më 07 Korrik 1989, banues në: 140, W. Saint Clair St., Romeo, MI 48065, mbajtës i pasaportës Nr. 566442338, dhe me adresë e-mail përfekt njoftimi sipas këtij dokumneti: [zack@x-identity.com](mailto:zack@x-identity.com), me zotësi të plotë përf të vepruar.

**Neni 2**

**Objekti**

2.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston kryesisht në:

*Dizenjime grafike dhe sherbime konsulencë ne kete fushe; brending; krijim imazhi dhe furnizimi me imazhe fotografike; administrimi strategjik i mediave sociale; krijimi, dizenjimi, furnizimi me imazhe dhe tekst dhe mirembatja e websiteve; marketing; organizimi i eveneve dhe konsulencë strategjike, financiare ose ligjore ne lidhje me organizin*

*Realizimi i renderave, animacioneve, perpunim i planimetrike arkitektonike, modelve ne 3D; maketeve; konsulence ne lidhje me arredimin dhe dizenjimin, perfshirë zhvillimin dhe realizimin ne 2D apo 3D të paraqitjes se projekteve potenciale;*

- 2.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose të shtohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

- 3.1 Aktiviteti i Shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
- 3.2 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

### **Neni 4**

#### **Selia e Shoqërisë**

- 4.1 Selia e Shoqërisë është Rruga "Ibrahim Rugova", Kullat "Green Park", Kati 3, Tiranë, Shqipëri..
- 4.2 Shoqëria mund të hapë degë, shoqëri bija, zyra përfaqësimi, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose në vende të tjera.
- 4.3 Shoqëria është e aftë të bëjë pjesë në shoqëri të tjera shqipëtare ekzistuese ose në të ardhmen në Republikën e Shqipërisë ose në vende të tjera.

### **Neni 5**

#### **Forma**

- 5.1 Themeluesit kanë themeluar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 5.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

### **Neni 6**

#### **Baza Ligjore**

- 6.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

6.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërите tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 7

#### Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë vulën e vetë. Administratori do të përdorë vulën.
- 7.2 Të gjitha dokumentet e Shoqërisë duhet të shoqérohen nga vula.

### KREU II

#### Kapitali

### Neni 8

#### Kapitali i Shoqërisë

- 8.1 Kapitali themeltar fillestari i Shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë.
- 8.2 Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 2 (dy) kuota.
- 8.3 Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:
  - Ortaku themelues: **Gjergji Prendi** – zoteron 1(një) kuotë, me vlerë të përgjithsme 5.000 (pesë mijë) Lekë, që përbën 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoërisë.
  - Ortaku themelues: **Zachary Michael Lennon** – zoteron 1(një) kuotë, me vlerë të përgjithsme 5.000 (pesëmijë) Lekë, që përbën 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit themeltar të Shoërisë.

### Neni 9

#### Transferimi i Kapitalit

- 9.1 Kuotat e kapitalit themeltar të Shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëprerjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

- 9.2 Për transferimin e kuotave kërohet miratimi i mëparshëm i shoqerisë. Ortaku që dëshiron të transferojë kuotën dhe/ose të drejtat e tij, duhet t'i propozojë shitjen më parë ortakëve të tjera të shoqërisë në të njëjtat kushte.

### **Neni 10**

#### **Rritja e Kapitalit**

- 10.1 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë unanimisht për rritjen e kapitalit.
- 10.2 Rritja e kapitalit mund të bëhet edhe nëpërmjet nënshkrimit të kuotave të reja të kapitalit nga ose ortakët e rinj. Ortakët e rinjë do të pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 10.3 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

### **Neni 11**

#### **Zvogelimi i Kapitalit**

- 11.1 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
- 11.2 Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **KREU III**

#### **Organet Vendimmrrëse dhe Drejtuese**

### **Neni 12**

#### **Organi Vendimmrrës**

- 12.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqerisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

- 12.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çeshtjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) shperndarjen e fitimeve
  - j) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 12.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 12.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

### Neni 13

#### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me postës elektronike. Njoftimi me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 13.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 14

## **Kuorumi**

- 14.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 14.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 14.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

## **Neni 15**

### **Marrja e vendimeve**

- 15.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, pér ndryshimin e statutit, zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 15.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, pér çështje te tjera si :
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 15.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Q.K.B pér të pasqruar ndryshimet në skedën e Shoqerisë.

## **Neni 16**

### **Përjashtimi nga e drejta e votës**

- 16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 17

#### Administrimi

- 17.1 Asambleja e përgjithshme emëron një person fizik si administrator të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 17.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 17.3 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:
- Z. **Ted Tase**, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë, Shqipëri, më 21 Shtator 1991, me numër ID 036351643

### Neni 18

#### Kompetencat e Administratorit

- 18.1 Administratori kanë të drejtë e detyrohet të:
- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

- ç) përgatisi dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

18.2 Administratori është i detyruar të thërasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston irreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

18.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 19

### Përgjegjësitë e Administratorit

- 19.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 19.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 19.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

- 19.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 19.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 19.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.
- 19.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit
- 19.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligure shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme.
- 19.9 Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

## **Viti finansiar-ekspertet**

### **Neni 20**

#### **Viti Financiar**

- 20.1 Viti finansiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

### **Neni 21**

#### **Ekspertët**

- 21.1 Eksperti kontabël i autorizuar zgjidhet më vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Eksperti ka për detyrë qe të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 21.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

## **KREU V**

### **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

### **Neni 22**

#### **Prishja dhe likuidimi**

- 22.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
  - d) me vendim të gjykatës;

- 22.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim e sipër”.

### Neni 23

#### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- 23.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

### Neni 24

#### Mosmarrëveshjet

- 24.1 Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund te lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


## ORTAKËT E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “X-Identity”

Gjergji Prendi



06/01/2022  
GJERGJI PRENDI

Zachary Michael Lennon



06/01/22  
ZACHARY LENNON